



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/72  
Datë: 27.04.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 23 të Ligjit Nr.08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në zbatim të Vendimit të Qeverisë Nr. 10/69 të datës 13 prill 2022 lidhur me mbështetjen e qytetarëve të Republikës së Kosovës në kuadër të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, Vendimit e Qeverisë lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike Nr.13/19 të datës 14 korrik 2021, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 12/31 të datës 25 gusht 2021, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 01/49 të datës 17 dhjetor 2021, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 15/62 të datës 23 shkurt 2022, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 prill 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet ndarja e mjeteve buxhetore në shumë prej 7,300,000 € (shtatë milionë e treqind mijë euro), për zbatimin e pikës 1.4 të Vendimit të Qeverisë Nr. 10/69 të datës 13 prill 2022, si masë për shtimin e mbështetjes për qytetarët e Republikës së Kosovës, përkatësisht në kuadër të masës 3.6 - Mbështetja e likuiditetit familjar të Pakos së Ringjalljes Ekonomike sipas Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14 korrik 2021, i ndryshuar dhe plotësuar.
2. Mjetet e ndara sipas pikës 1. të këtij Vendimi merren nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me kod (201) nga nën-programi "Programi i Ringjalljes Ekonomike" me kod 29300, nga kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere" dhe ndahen në nën-programin Thesari me kod 11200, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", për zbatimin e masës shtesë për punonjësit e sektorit publik që marrin pagë nga buxheti i shtetit.
3. Mjetet sipas këtij Vendimi transferohen, buxhetohen dhe alokohen në kodin e përcaktuar (00098) në programin përkatës, për ekzekutimin e pagesës së subvencionimit për listën e përfituesve të gjeneruar sipas kritereve dhe kushteve të përcaktuara me Vendimin e Ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve Nr. 27/2022, të datës 21 prill 2022, sipas autorizimeve të pikës 3. të Vendimit të Qeverisë Nr. 10/69 të datës 13 prill 2022.
4. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për zbatimin e këtij Vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**  
PER   
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë